



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOVOVA
KUVENDI I KOMUNËS – SKUPSTINA OPSTINE
VUSHTRRI –VUCITRN



Bazuar në nenin 12.2 “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 31 të Statutit të Komunës si dhe duke u bazuar në propozimin e grupit parlamentar të AAK-së përkatësisht kryetarit të këtij grupi të Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 29.07.2010 miraton këtë:

DEKLARATË

1. Kuvendi i Komunës në Vushtri shprehë shqetësim dhe kundërshton vendimin e Tribunalit të Hagës për rigjykim të pjesshëm të z. Ramush Haradinaj, Kryetar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.
2. Kuvendi i Komunës konsideron se ky vendim është i padrejtë kur dihet se Tribunali me vendim unanim, me datën 03.04.2008 z. Haradinaj e kishte liruar nga të gjitha pikat e akt-akuzës dhe e kishte shpallur të pa fajshëm.
3. Kuvendi, kërkon publikisht nga institucionet kompetente qendrore vendore dhe ndërkombëtare që të ndërmarrin masat e mundshme për mbrojtje në liri të z. Haradinaj.
4. Duke besuar në pafajësinë e plotë të z. Haradinaj të dëshmuar sikurse edhe në rastin e parë që u shpall plotësisht i pafajshëm nga Triunali i Hagës, kuvendi beson se edhe në këtë rast drejtësia do të triumfoj, kur dihet se e gjithë puna dhe veprimtaria e tij gjatë luftës në Kosovë ishte në frymën e luftës së drejtë të UÇK-së për çlirimin një herë e përgjithmonë të Kosovës nga Serbia.
5. Deklarata iu dërgohet mjeteve të informimit publik.

Kryesuesi i Kuvendit
Ferit Idrizi